VENDIM
Nr. 727, datë 20.11.2024

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 867, DATË 10.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E BASHKËPUNIMIT NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të nenit 10, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës "g", të pikës 2, të nenit 6, të shtojcës A, "Marrëveshje bashkëpunimi (tip)", bashkëlidhur vendimit nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore", të ndryshuar, shtohet shkronja "gj", me këtë përmbajtje:

"gj) në rastet kur evidentimi në terren kryhet nga specialistët e bashkisë, akti i evidentimit në terren nënshkruhet prej tyre, sipas formatit të miratuar në vendimin nr. 1178, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.".

2. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe të gjitha bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku